



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 24.15.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR  
TË AGJENCISË SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Shkëlqim Xhema dhe Anëtare e ekipit Leonora Hasani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymeri.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	20
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	21
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	24
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	26

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 21/02/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar


Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm – auditimi 2016**

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AShMDhP) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### 1.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

#### Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të**

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm në mungesë të Kryesuesit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

---

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

AShMDhP kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi çështje për të ngritur. Ata kanë marrë parasysh sugjerimet tona të dhëna në Pasqyrat Financiare Nëntëmujore.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.



## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AShMDhP-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga AShMDhP siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në AShMDhP në lidhje me llogaridhënien dhe cilësinë e raportimit menaxherial pasqyron një situatë pozitive. Raportimi ishte në nivel të duhur. Mënyra dhe forma e raportimit nga aspekti funksional-operativ janë të rregulluar me ligjin përkatës të Agjencisë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) nga MF ka realizuar një auditim. Raporti i këtij auditimi i kishte ofruar një pasqyrë të qartë menaxhmentit mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Megjithatë, në kuadër të qeverisjes AShMDhP-ja edhe më tutje nuk e kishte hartuar matricën e rreziqeve.

---

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e AShMDhP-së për vitin 2015, ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, tri (3) rekomandime janë zbatuar, një (1) është në proces dhe pesë (5) nuk janë zbatuar ende. Një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni Shtojcën III.

---

### Çështja 1 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraparak - Prioritet i lartë

**E gjetura** AShMDhP ka hartuar me kohë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit 2015, mirëpo pjesa më e madhe e rekomandimeve nuk janë zbatuar. Në këtë aspekt përveç planit të veprimit, kanë munguar veprimet e nevojshme nga menaxhmenti dhe nga personat përgjegjës.

Rekomandimet e pa zbatuara ndërlidhen me fushat, si: mos zbatimin e kërkesave për menaxhimin e rrezikut, realizimin e pagesave (zotimet me kohë dhe vonesat në realizimin e pagesave), menaxhimi i personelit si dhe raportimi i obligimeve të papaguara. Si pasojë e mos zbatimit të rekomandimeve, dobësitë e njëjta vazhdojnë ta përcjellin Agjencinë.

**Rreziku** Zbatimin jo i plotë të rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e dobësive të identifikuar, përsëritjen e vazhdueshme të mangësive të njëjta si dhe mungesën e evitimit/parandalimit të tyre.

**Rekomandimi 1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës në këtë proces. Procesi të rishikohet në vazhdimësi në mënyrë që të ndërmerren veprime ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

## 2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të saj. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për AShMDhP-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo ka për qëllim të mbështesë përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

### Çështja 2 - Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut – Prioritet i lartë

**E gjetura** AShMDhP kishte filluar të mbante takime të rregullta mujore mbi identifikimin e rreziqeve dhe sfidave, mirëpo ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve që identifikon pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave.

Kjo tregon mungesë të llogaridhënies ndaj menaxhmentit të lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut. Për menaxhimin efektiv të rrezikut nevojiten veprime të qarta, të cilat duhet të zbatohen për të gjitha rreziqet domethënëse që kanë ndikim tek organizata.

**Rreziku** Mos veprimi i agjencisë në identifikimin e rreziqeve reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda organizatës buxhetore, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë që mund të ndërliken me objektivat e saj.

**Rekomandimi 2** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që ka deleguar përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut dhe të sigurojë raportim për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar menaxhimin e rreziqeve në vazhdimësi.

---

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit AShMDhP operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Vlen të theksohet, që AShMDhP-ja nga muaji korrik i vitit 2016, është në mungesë të Kryesuesit dhe anëtarëve të Këshillit. Po ashtu, edhe ndryshimet e ligjit të AShMDhP janë në proces. Deri në aprovimin e ligjit të ri, AShMDhP-ja menaxhohet nga drejtori i përgjithshëm i agjencisë, i cili raporton në emër të saj.

Procesi i raportimit të brendshëm në AShMDhP funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet. Për këto, menaxhmenti deri në qershor të vitit 2016 kishte mbajtur edhe procesverbale të takimeve.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave të Udhëzimit Administrativ nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, AShMDhP nuk i plotëson kriteret për themelimin e saj.

Megjithatë me qëllim të forcimit të kontrollit të brendshëm, AShMDhP-ja kishte kërkuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-së për të kryer shërbimet e auditimit të brendshëm.

Për vitin 2016, është kryer një auditim me temë “Funksionimit të AShMDhP-së”. Në këtë raport janë dhënë gjashtë (6) rekomandime lidhur me përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm, rekomandime këto të cilat ishin në proces të zbatimit.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

AShMDhP në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2016, AShMDhP ka përdorur 91% të buxhet final, më një realizim më të ulët për 8% në raport me vitin paraprak. Në uljen e përqindjes ka ndikuar nën shpenzimi i buxhetit të pagat dhe mëditjet, pas përfundimit të mandatit të Kryesuesit dhe anëtarëve të këshillit në muajin korrik 2016.

Në menaxhimin e përgjithshëm dhe kontrolleve, ka nevojë për përmirësime në procesimin e lëndëve për pagesë (ka vonesa në procesim të pagesave), pranimin e mallrave dhe shërbimeve pas zotimit të mjeteve si dhe në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara.

Më tutje AShMDhP, ka vazhduar me ushtrues detyre për periudha më të gjatë se tre (3) muaj ndërsa veprime përmirësuese ka nevojë edhe në menaxhimin e pasurisë.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>354,058</b>	<b>294,483</b>	<b>268,062</b>	<b>348,713</b>	<b>369,682</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	354,058	293,833	268,062	337,167	369,682
Donacionet e jashtme	-	650	-	11,546	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 59,575€. Ky zvogëlim është në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2016, ASHMDhP ka përdorur 91% të buxhet final ose 268,062€, me një shpenzim për 8% më të ulët në raport me vitin 2015. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>354,058</b>	<b>294,483</b>	<b>268,062</b>	<b>348,712</b>	<b>369,682</b>
Pagat dhe Mëditjet	217,160	187,560	162,358	208,358	183,567
Mallrat dhe Shërbimet	130,448	104,562	103,343	139,134	132,739
Shërbimet Komunale	6,450	2,361	2,361	1,220	3,486
Investimet Kapitale	-	-	-	-	49,890

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Te kategoria e pagave dhe mëditjeve, buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 29,600€ me vendim të Qeverisë;
- Buxhetit final për mallra dhe shërbime është zvogëluar për 25,886€ në raport me atë fillestar, me vendim të Qeverisë; si dhe
- Buxheti final për komunal, po ashtu është zvogëluar për 4,089€ nga ai fillestar.

Ndër arsytet e këtyre ndryshimeve buxhetore është përfundimi i mandatit të Kryesuesit dhe këshillit të ASHMDhP-së në korrik të vitit 2016.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

### 3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar. Kontrollat kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e ASHMDhP-së. Buxheti fillestar ishte 217,160€ ndërsa ai final ishte 187,560€.

Në këtë kategori janë shpenzuar 87% të buxhetit final apo 162,358€. Kjo përqindje e ulët vjen si rezultat i përfundimit të mandatit të Kryesuesit dhe anëtarëve të këshillit të ASHMDhP-së nga korriku i vitit 2016. Testimi ynë ka nxjerr në pah dobësinë në çështjen e paraqitur në vijim:

#### Çështja 3 - Plotësimi i pozitave me ushtrues detyrë më gjatë se tre muaj - Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas Ligjit të Shërbimit civil, në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, Ushtruesi i Detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj. Ndërsa, emërimi i drejtpërdrejtë në pozita të lira, në kundërshtim me parimin e meritës, nuk është i lejuar.

Në ASHMDhP, në mungesë të aprovimit të pozitave shtesë, vazhdojnë të mbulohen pozitat me UD për periudha të gjata, si:

- Pozita e ZKF-së që nga themelimi i Agjencisë mbulohet me UD (nga viti 2014). Së fundmi, pozita e ZKF-së është duke vazhduar të menaxhohet me UD nga zyrtarët me radhë;
- Pozita e zyrtarit certifikues ushtrohet me UD nga viti 2013; si dhe
- Pozita e zyrtarit për të hyrave dhe zyrtarit të prokurimit mbulohen me detyra shtesë si UD nga viti 2014.

Për këto çështje kemi rekomanduar edhe në vitin e kaluar, mirëpo kjo praktik mbetet ende sfidë e ASHMDhP-së, pasi që edhe përkundër kërkesave për aprovim të pozitave shtesë me buxhet, vazhdimisht ka mungesë të stafit.

**Rreziku** Avancimi, përkatësisht praktika e mbulimit të pozitave kyçe me U.D për periudha të gjata kohore përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme.

**Rekomandimi 3** Drejtori i Përgjithshëm duhet të ndërmer veprime për rekrutimin e stafit të rregullt sipas kërkesave ligjore në mënyrë që të ndërpritet mbulimi i pozitave me UD. Pozitat me UD nuk duhet të jenë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.

### 3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë edhe komunalitë) në vitin 2016 ishte 106,923€. Prej tyre ishin shpenzuar 105,704€, ose mbi 99%. Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar 54 pagesa në vlerë 60,832€ si dhe dy procedura të prokurimit në vlerë 1,595€.

Sa i përket procedurave të prokurimit të institucioneve të pavarura që kanë më pak se 50 të punësuar bazuar në paragraf 2 të nenit 21/A të LPP nr. 05/ L-068 i kryen Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). AShMDhP-ja është ndër institucionet që nuk plotësojnë kriteret për të pasur zyrën/zyrtarin e prokurimit.

Testimi ynë ka nxjerr në pah disa dobësi në çështjet e paraqitura në vijim.

#### Çështja 4 - Anashkalim i rregullave të thesarit gjatë procesimit të pagesave - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë.

Në 18 pagesa në vlerë 18,300€ në AShMDhP, vërejtëm se zotimi i mjeteve dhe urdhërblerjet ishin bërë pas pranimit të faturës.

Kjo çështje ishte rekomandim edhe në vitin e kaluar, mirëpo nuk është zbatuar. Sipas zyrtarëve të agjencisë, kjo ndodhë për shkak të mungesës së stafit të nevojshëm si dhe angazhimit të tyre edhe me punë shtesë apo ushtrojnë pozita tjera të caktuara.

**Rreziku** Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme do të rezultojë në vonesa të zbatimit të kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues. Ndërsa, kryerja e pagesave para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallra të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme.

**Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPN-ën, dhe me rregullat e Thesarit.



---

**Çështja 5 - Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetit pas skadimit të kontratës - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** AShMDhP kishte bërë mirëmbajtjen dhe riparimin e automjetit pas skadimit të kontratës në vlerë prej 1,024€. Kontrata kishte hyrë në fuqi më 08.06.2015 dhe kishte përfunduar më 25.05.2016. Ndërsa servisimi për një automjet ishte bërë me datën 03.08.2016. Si rrjedhojë AShMDhP ka riparuar automjetin duke shfrytëzuar kontratën e skaduar me operatorin ekonomik. Kjo kishte ndodhur si rezultat i vonesave të AQP-së në lidhjen e kontratave.
- Rreziku** Ekzekutimi i pagesave pas skadimit të kontratës rrit rrezikun e pagesave të parregullta si dhe keq përdorim të parasë publike.
- Rekomandimi 5** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj kontroll të duhur, në mënyrë që pagesat të kryhen sipas kushteve të kontratës dhe brenda afateve ligjore të saj.

**Çështja 6 - Vonesë në realizimin e pagesave - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** Rregulla financiare nr. 01/2013/MF përcakton se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve, në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë.
- AShMDhP nuk kishte arritur të kryejë pagesat në afatin e përcaktuar ligjor. Në pesë (5) pagesa në vlerë 4,891€, kemi vërejtur që ato ishin vonuar nga 12 deri në 107 ditë pas afatit 30 ditësh për pagesë. Lidhur me këtë, ne kemi rekomanduar edhe vitin e kaluar.
- Rreziku** Vonesat në realizimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa të ndëshkimeve ndaj operatorëve ekonomik si dhe krijimin e obligimeve të cilat do të rëndojnë buxhetin e vitit vijues.
- Rekomandimi 6** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë mbikëqyrje të rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.

---

## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale dhe jo kapitale e AShMDhP-së për vitin 2016 ishte 114,956€. Prej tyre pasuria me vlerë mbi 1,000€ ishte 89,263€, ndërsa pasuria më vlerë nën 1,000€ ishte 25,693€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores së MF 02/2013 për menaxhimin e pasurisë qeveritare, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive. Lidhur me këtë ne testuam 31 mostra, përfshirë pasurinë mbi dhe nën vlerën 1,000€. Testimi ynë ka nxjerr në pah disa dobësi si në çështjen e paraqitura në vijim:

---

#### Çështja 7 – Mos azhurnim i regjistrit të pasurive - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Sipas Rregullores së MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Organizata duhet të themelojë regjistrë kontabël të pasurive jo financiare ku, përveç informatave të kërkuara nga LMFPP, do të përfshihen edhe elemente si: emri i organizatës buxhetore; emri i pasurisë; përshkrimi; numri serik; numri i bar-kodit; data e pranimit, etj.

Në AShMDhP kemi testuar 31 pasuri mbi dhe nën vlerën 1,000€ për të verifikuar ekzistencën e tyre. Prej tyre, 21 pasurive ju mungonte bar-kodi. Zyrtari i pasurive kishte shtypur bar-kodet mirëpo nuk i kishte vendosur në pasuritë përkatëse. Ndërsa në regjistrë të pasurive figuronte bar kodi për secilën pasuri.

**Rreziku** Dobësitë në regjistrin e pasurive në mungesë të numrit të bar-kodit dhe shënimeve tjera, mund të krijoj paqartësi me rastin e inventarizimit dhe paraqet rrezik për keqpërdorimin ose humbjen tyre.

**Rekomandimi 7** Drejtori i Përgjithshëm, duhet të forcoj kontrollet për të siguruar se të gjitha pasuritë janë pajisur me të gjitha elementet e kërkuara për të siguruar menaxhim më efikas të tyre.

---

### 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 542€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Testimi ynë ka nxjerr në pah disa dobësi në raportimin e obligimeve e cila është paraqitur në vijim.

---

#### Çështja 8 - Raportim jo i drejtë i obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Ne testuam mënyrën e raportimit të obligimeve të papaguara duke filluar nga protokollimi, raportimi e deri te pagesa e obligimeve dhe anasjelltas. Nga tri (3) pagesat e testuara në vlerë 2,527€, ne identifikuam se ato nuk ishin raportuar në raportet mujore për obligimet e papaguara, si:

- Fatura në vlerë 594€ e protokolluar në dhjetor 2015 ishte paguar në maj 2016;
- Fatura në vlerë 947€ e protokolluar në shkurt 2016 ishte paguar në qershor 2016; si dhe
- Fatura në vlerë 986€ e protokolluar në maj 2016 ishte paguar në qershor 2016.

Këto fatura përveç se ishin vonuar për pagesë, nuk ishin përfshirë as në raportet e obligimeve të papaguara të përgatitura/dorëzuara në MF.

**Rreziku** Mos raportimi i saktë i obligimeve mujore rrit rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë, si dhe ekspozohet para ndëshkimeve të mundshme nga furnitorët.

**Rekomandimi 8** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrolle shtesë në raportimin e obligimeve, ashtu që vlerat e sakta të raportohen për periudha të sakta kohore dhe të përcillen nga muaji në muaj derisa të paguhen.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë një plan të rishikuar të veprimit, i cili përcakton qartë një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e të gjitha rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet në baza të rregullta kohore.		Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve të AP-së, pesë (5) prej tyre kanë mbetur të pa zbatuara.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë së kanë hartuar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, si dhe ka caktuar një person përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza mujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.			Nuk është zbatuar
3.4 Prokurimi	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPF-në, dhe me rregullat e Thesarit.			Nuk është zbatuar
	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë mbikëqyrje të rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.			Nuk është zbatuar
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se do të ndërpritet praktika e financimit të pagave nga mallrat dhe shërbimet. Me tutje të bëjnë përpjekje që në buxhetin e vitit në vijim të përfshihen pagat për të gjithë të punësuarit, dhe pagesa e tyre të realizohet përmes sistemit të pagave.	Po		



3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë kontrolle shitesë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Procedurat e rekrutimit duhet të fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar më kërkesat ligjore.			Nuk është zbatuar
3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se kontrollet në menaxhimin e pasurisë janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Regjistrat e pasurisë duhet të azhurnohen rregullisht nga zyrtarët përgjegjës si dhe në fund të çdo viti ky regjistër duhet të harmonizohet më regjistrin e inventarizimit të pasurisë. Më tej të sigurojë se janë duke vazhduar përpjekjet (kërkesat në MAP) për instalimin e sistemit e-pasuria.	Po		
	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë që menaxhimi i automjeteve bëhet në pajtueshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ. Të gjithë shfrytëzuesit e automjeteve duhet të raportojnë rregullisht lidhur me kilometrat e kaluara dhe shpenzimet e derivateve. Me tej Zyrtari Çertifikues, para certifikimit të secilës lëndë për pagesë duhet të sigurojë që ekzistojnë të gjitha dëshmitë mbështetëse.	Po		
3.6.2 Trajtimi i borxheve	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme për të përmirësuar mënyrën e raportimit të obligimeve, qoftë përmes trajnimit të stafit, ose përmes formave tjera.			Nuk është zbatuar

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre (Përveq në rastet ju më duhet të caktojë personel ushtrues deytre në mungesë të personelit, pasi që ASHMHDP numëron vetëm 18 shërbyes civil)

z. Bujar Sadiku

Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

Data: 12.Qershor.2017, Prishtinë

